

Bursa “The Kosovo Banker”

I. Thirrja për konkurs për ndarjen e bursës studentore “The Kosovo Banker”

Me rastin e 10 vjetorit të publikimit të revistës ekonomike “The Kosovo Banker” dhe në funksion të nxitjes së hulumtimeve mes ekonomistëve të rinj të Kosovës, Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) ka krijuar mundësinë e dhënies së bursës studentore “The Kosovo Banker” për artikullin më të mirë të paraqitur nga ekonomistët e rinj dhe përfshirjes së artikullit në edicionin e 20-të të revistës “The Kosovo Banker” që do të publikohet me 15 korrik, 2022.

Punimet për bursën duhet të jenë me orientim në fushën e sektorit financiar dhe zhvillimit ekonomik në Kosovë, me theks të veçantë, duke iu përshtatur rrethanave të reja të krijuara gjatë vitit 2021/22 në vend dhe ekonominë globale. Duke vlerësuar rëndësinë e rrethanave të krijuara, tema e këtij edicioni për të cilin duhet shkruar artikullin është: “Presionet Globale Inflacioniste: Ndikimet në Kosovë dhe Rajon”.

Lidhur me këtë, për nder të dhjetëvjetorit të revistës “The Kosovo Banker”, SHBK do të organizojë një ngjarje të veçantë për shpalljen e punimeve më të mira të dorëzuara, siç përcaktohet në vijim;

II. Kushtet për ndarjen e bursës studentore

Të drejtën e aplikimit për bursë e kanë studentët e regjistruar në studimet universitare në nivelin e parë të studimit (Bachelor) në universitete publike dhe private në Republikën e Kosovës dhe të cilët plotësojnë kushtet e më poshtme:

1. Të jenë student të rregullt të fakultetit ekonomik
2. Të kenë notën mesatare jo më të ulët se 8.0
3. Të mos jenë shfrytëzues të bursave tjera
4. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës

III. Kriteret për punimin e artikullit shkencor janë:

1. Artikulli duhet të plotësojë kriteret e një artikulli shkencor
2. Artikulli duhet të jetë i punuar enkas për këtë konkurs dhe që nuk është publikuar më parë, pra punimi duhet të punohet gjatë fazës së konkursit të hapur për aplikim. Aplikuesi duhet të jetë autori kryesor i punimit të dorëzuar.
3. Tema duhet të jetë e shkruar në gjuhën shqipe ose gjuhën angleze.
4. Punimi i dorëzuar nuk duhet të ketë më shumë se 2500 fjalë, lloji i shkrimit të jetë Times New Roman 12, hapësirë 1,5. Përmbledhja ekzekutive nuk duhet të jetë më e gjatë se 500 fjalë dhe lista e të gjitha referencave duhet t'i bashkëngjitet punimit.

IV. Kriteret e vlerësimit për punimin e artikullit shkencor janë:

- (a) Rëndësia e artikullit për ekonominë e Kosovës dhe në ndërlidhje me atë ndërkombëtare.
- (b) Cilësia e hulumtimit dhe mendimi kritik.
- (c) Cilësia e të shkruarit dhe artikulimi i rrjedhshëm i koncepteve ekonomike të argumentuara në artikull.
- (d) Hulumtimet dhe shkrimet e të tjerëve të përfshira në punimin e paraqitur duhet të identifikohen mirë në fusnotat dhe referencat bibliografike.

Studentët e interesuar për aplikim mund të aplikojnë:

- Duke dorëzuar aplikacionin dhe dokumentet tjera të skenuara si dhe punimet e tyre në version elektronik word doc, në contact@bankassoc-kos.com

Data e fundit për dorëzim të aplikacionit dhe punimit do të jetë: 20 maj 2022, ora 12:00pm.



FORMA E APLIKIMIT

Bursa Studentore "The Kosovo Banker" 2022/23

Emri dhe Mbiemri:	
Niveli i studimeve:	
Universiteti:	
Fakulteti/Departamenti:	
Numri i ID studentore:	
Numri personal:	
Vendi:	
Numri kontaktues:	
E-mail:	

Studentët e interesuar mund të aplikojnë duke i bashkëngjitur dokumentet si në vijim:

- 1. Kopjen e letërnjoftimit**
- 2. Kopjen e ID studentore**
- 3. Dëshmia e notës mesatare**
- 4. Deklarata personale që nuk jeni përfitues i ndonjë burse tjetër**
- 5. Punimin e artikullit shkencor**

Duke dorëzuar aplikacionin dhe dokumentet tjera të skenuara si dhe punimet e tyre në version elektronik word doc, në contact@bankassoc-kos.com

***Shënim:** Me rastin e dërgimit të kësaj forme të aplikacionit, konfirmoj se aplikoj për konkursin e shpallur për bursën studentore "The Kosovo Banker" dhe pajtohem që informatat e dhëna në këtë formular mund të përdoren për qëllime të këtij konkursi. Unë e kuptoj se çdo informacion i dhënë nga unë që rezulton të jetë i rremë, i paplotë ose i keqinterpretuar do të jetë shkak i mjaftueshëm për tu eliminuar nga shqyrtimi i mëtejshëm apo edhe nga ndërprerja e përfitimit të bursës.